

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses - SH.A. 'I.' nga P., të cilën me autorizim e përfaqëson T. B., avokat nga Gj., me bazë juridike anulim i vendimit të të paditurës – Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) nr..... dt, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të paditëses paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.368/2016 dt.16.02.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 10.05.2018, mori këtë

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesa e paditëses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.368/2016 dt.16.02.2017.

II. NDRYSHOHEN, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, AA.UZH.nr.368/2016 dt.16.02.2017, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit administrativ A.U.nr.707/2016 dt.08.09.2016.

III. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses SH.A. 'I.' nga P.

IV. ANULOHEN, aktvendimi i të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës, nr..... dt..... dhe aktvendimi i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër KK P. nr..... dt.....

V. DETYROHET Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër KK P. të bëjë ndryshimin në operatin kadastral për ta regjistruar paluajtshmërinë në listat poseduese nr.... dhe ... KK P., nga Ndërmarrja Ndërtimore 'I.' nga P. - në SH.A. 'I.' nga P., në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.368/2016 të datës 16.02.2017, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses SH.A. 'I.' nga P. dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative

A.U.nr.707/2016 dt.08.09.2016, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses e cila ka kërkuar që të anulohet aktvendimi i të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës (shkurt. AKK) nr..... dt.... me të cilin është refuzuar ankesa e palës paditëse dhe është vërtetuar Aktvendimi i Drejtorisë për Gjeodezi dhe kadastër të KK P. nr..... dt....

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.368/2016 dt.16.02.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departmaneti administrativ A.U.nr.707/2016 dt.08.09.2016 paditësja ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe të shkeljes së dispozitave të procedurës, me propozim që të ndryshohen aktgjykimët e kontestuar, duke e aprovuar padinë e paditëses dhe duke i ndryshuar aktvendimet e organeve administrative.

Gjykata Supreme e Kosovës mbajti seancën, ekzaminoi aktgjykimin e kontestuar, vlerësoi pretendimet e paraqitur në kërkesë dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, në pajtim me nenin 53 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), konstatoi:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër KK P., me nr.... dt..... është refuzuar ankesa e paditëses, për regjistrimin e ndryshimeve statusore të paluajtshmërive në operatin kadastral KK P., me arsyetimin se nuk janë plotësuar të gjitha kushtet e cekura në informatën e kësaj drejtorie nr.... dt..... Me aktvendimin e AKK-së nr..... të datës , është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses dhe është vërtetuar aktvendimi i lartcekur i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër të KK P. Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, me aktgjykimin A.U.nr.968/2012 dt.13.09.2013 ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i AKK-së nr. dt..... Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, AA.UZH.nr.352/2013 dt. 09.12.2014, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses dhe është vërtetuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, A.U.nr. 968/2012 dt.13.09.2013. Me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ.UZVP.nr.8/2015 dt.30.12.2015 është aprovuar si e bazuar kërkesa e paditëses, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe janë anuluar të dy aktgjykimet, ai i Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr. 352/2013 dt.09.12.2014 dhe i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dep.administrativ A.U.nr.968/2012 dt.13.09.2013, ndërsa lënda është kthyer në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim, pasi që aktgjykimet e tyre janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave ligjore. Në riprocedim, duke vepruar sipas aktgjykimit të përmendur të GJSK, gjykata e shkallës së parë nxjerr aktgjykimin A.U nr.707/2016 dt.08.09.2016 me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditëses për anulimin e aktvendimit e të paditurës- AKK nr..... dt..... me të cilin është refuzuar si e pabazuar ankesa e palës paditëse dhe është vërtetuar aktvendimi i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në P. nr..... dt..... Duke vepruar lidhur me ankesën, Gjykata e Apelit nxjerr aktgjykimin AA.UZH.nr.368/2016 dt.16.02.2017 me të cilin e refuzon si të pabazuar ankesën e paditëses.

Lidhur me kërkesën e paditëses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.368/2016 dt.16.02.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dep.administrativ A.U.nr.707/2016 dt.08.09.2016, Gjykata Supreme vendosi të aprovojë si të bazuar kërkesën e paditëses (par I), të ndryshojë, aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.368/2016 dt.16.02.2017 dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë A.U.nr.707/2016 dt.08.09.2016 (par.II), të aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses SH.A. 'I.' nga P. (par.III), ndërsa në paragrafin IV të këtij aktgjykimi vendosi të anulojë aktvendimin e të paditures AKK nr..... dt....., dhe aktvendimin e Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër KK P. nr..... dt..... Në fund, në paragrafin V kjo Gjykatë detyroi Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër KK P. të bëjë ndryshimin statusor në operatin kadastral duke i regjistruar ndryshimet në paluajtshmëritë nr..... dhe KK P., nga Ndërmarrja Ndërtimore 'I' nga P. në SH.A. 'I.' nga P., në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Në riprocedim, gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, edhe pse ishin të detyruara, nuk kanë vepruar sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna në aktgjykimin e Gjykatës Supreme ARJ.UZVP.nr.8/2015 dt.30.12.2015. Përkundrazi, kanë nxjerrë aktgjykime identike me ato që tashmë kishin qenë objekt shqyrtimi të kësaj Gjykate dhe të cilat ishin anuluar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të nenit 182.2 (n) të LPK-së, të zbatuar sipas nenit 63 të LKA-së.

Në arsyetimin e tyre, gjykatat e instancës më të ulët vlerësojnë si të drejt veprimin e organeve administrative që kishin refuzuar kërkesën e paditëses për regjistrimin e paluajtshmërisë në bazë të certifikatave të pronësisë nr..... dhe KK P., duke iu referuar Udhëzimit Administrativ (UA) 15/2010, përkatësisht Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222.

Është e pakontestueshme se neni 32.1 i Ligjit të lartëcekur përcakton se një barrë është ngarkesë apo pengesë që një person ka në pasurinë e tjetrit, si siguri për një borxh apo obligim. Në rast të tatimeve të cilat nuk janë paguar në afatin e përshkruar në ligj, neni 33.1 i këtij Ligji parasheh se nëse një person i cili është i detyruar t'i paguaj një lloj tatimi brenda 10 ditësh pas dorëzimit të njoftimit të vlerësimit, sikurse është paraparë në nenin 22 të këtij Ligji, mbi të gjithë pasuritë që i përkasin atij personi, do të vendoset një barrë pagese në një shumë të barabart me tatimin e papaguar, plus interesin dhe shpenzimet e mbledhjes. Paragrafi 3 i të njëjtit nen përcakton se barra tatimore regjistrohet në regjistrat publik, me qëllim të vendosjes në përparsi të ATK-së, në lidhje me transaksionet eaktuara dhe palët tjera të interesuara. Kjo Gjykatë nuk mund t'i pranojë si të drejta pikëpamjet e tilla juridike të gjykatave të instancës më të ulët të paraqitura në aktgjykimet e tyre, për shkak se në arsyetimin e tyre nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare ose ato janë të paqarta dhe kundërthënëse e, po ashtu, për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimeve thuhet të dokumentit ose të proceverbalit. I padituri, me kërkesën nr..... dt..... i është drejtuar organit të shkallës së parë për ndryshimet në operatin kadastral lidhur me parcelat e lartëpërmendura në bazë të vendimit

nr.....dt..... për themelimin e shoqatës aksionare ‘I.’ në P. Kërkesa për regjistrimin e ndryshimit statusor nuk do të thoshte e nuk nënkupton as sot ndryshim të pronësisë mbi paluajtshmëritë, por regjistrim të ndryshimeve në strukturën e pronësisë të ish ndërmarrjes ndërtimore ‘I.’ nga P. – si Shoqatë Aksionare. Arsyet e dhëna nga ana e gjykatave të instancës më të ulët lidhur me pengesa juridike, mospagesën e tatimit dhe pjesmarrjen e Agjencionit për privatizim në procesin e ndryshimit në operatin kadastral janë të paqarta dhe të pabazuara në ligj. Pra, kërkesa e paditëses lidhur me ndryshimet në regjistrin kadastral nuk nënkupton ndryshimin e pronësisë mbi paluajtshmëritë, por ndryshimin e strukturës pronësore të paditëses e cila me kontratën për themelimin e shoqatës aksionare ‘I.’ ka bërë vetëm ndryshimin në strukturën pronësore, ashtu që nga Ndërmarrja Shoqërore- Ndërmarrja Ndërtimore ‘I.’ P. ka kaluar në Shoqatën Aksionare ‘I.’ Pejë /SH.A. ‘I.’ nga P./ Nisur nga ky fakt, Gjykata Supreme konsideron se detyrimi tatimor nuk mund të jetë shkak për refuzimin e kërkesës për regjistrimin e ndryshimeve në operatin kadastral. Është kështu, sepse me nenin 3.2 të Ligjit për Themelimin e Regjistrimit për të Drejtat mbi pronat e paluajtshme nr.2002/5 është parashikuar se parashtruesi i kërkesës për regjistrimin e këtyre të drejtave kërkesës duhet t’ia bashkangjet dokumentacionin me të cilin dëshmohet e drejta e pronësisë mbi paluajtshmërinë ashtu siç është përcaktuar me Ligjin e zbatueshëm sipas nenit 3.7 të tij. E drejta mbi pronësinë mbi paluajtshmërinë parashikuar në nenin 2 të këtij Ligji do të regjistrohet në bazë të: vendimit gjyqësor të formës së prerë, vendimit të organit administrativ, kontratës për kalimin e të drejtës mbi pronën e paluajtshme të legalizuar pranë organit kompetent, vendimit ose kontratës së privatizimit lëshuar nga AKP, vendimit të Komisionit Kadastral, Komisionit për Rregullimin e Tokave dhe dokumentave të tjera në bazë të cilave kryhet regjistrimi i të drejtës pronësore në mbështetje të ligjeve të veçanta. Në nenin 5 të UA nr.2004/3 parashikohet baza ligjore e regjistrimit të së drejtës pronësore mbi paluajtshmërisë sipas së cilës kjo e drejtë mund të këtë mbështetje mbi çdo dokument të vlefshëm që nxjerrë organi kompetent gjyqësor ose organi administrativ mbi vendimin gjyqësor përfundimtar ose mbi transakcionit ligjor që është në përputhe me ligjet në fuqi. Duke pasur parasysh kontratën për themelimin e SHA ‘I.’ në P. me pronësi të përzier dhe regjistrimin e kryer te Gjykata Ekonomike në Prishtinë-Aktvendimi Fi.nr.6285/92 dt.17.11.92, Gjykata Supreme konsideron se, tani për tani, janë të papranushme pikëpamjet juridike të gjykatave të instancave më të ulëta, të paraqitura në arsyetimet a aktgjykimeve të tyre,sepse, sipas mendimit e kësaj Gjykate paditësi ka kërkuar që emërtimi i pronarit të bëhet në përputhje me ndërrimet e tij statusore dhe jo të kryhet ndërrimi i pronësisë. Kjo, për më tepër kur merret parasysh fakti se kërkesa për ndryshime në operatin kadastral është paraqitur me Arsyetimi i organeve administrative dhe i gjykatave të instancave më të ulëta se në procedurën e zhvilluar sipas kërkesës së paditëses për ndryshime në operatin kadastral, nuk ka marrë pjesë AKP-ja, sipas mendimit të kësaj Gjykate, nuk mund të jetë shkak për refuzimin e kërkesës së paditëses për ndryshimet në operatin kadastral, sidomos kur merret parasysh data e paraqitjes së kërkesës së parë për ndryshime (viti) dhe fakti që organi administrativ i shkallës së parë ka mundur edhe vetë të kërkojë nga kjo agjenci mendimin për ligjshmërinë e kërkesës për regjistrimin e ndryshimeve në operatin kadastral.

Andaj, duke pasur parasysh edhe faktin se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë nuk kanë marrë fare për bazë udhëzimet të cilat ishin dhënë nga kjo Gjykatë në aktgjykimin ARJ.UZVP.nr.8/2015 dt.30.12.2015, me të cilin ishin prishur aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.368/2016 dt.16.02.2017 dhe aktgjykimi i Departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.U.nr. 707/2016 dt.08.09.2016, duke marrë në riprocedurë pothuajse aktgjykime identike dhe, duke qenë se provat që ekzistojnë në shkresat e lëndës janë të mjaftueshme për të marrë një vendim merititor – Gjykata Supreme mori aktgjykimin me të cilin e aprovoi si të bazuar kërkesën e paditëses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paraqitur kundër vendimeve të mësipërme të të dy gjykatave të instancës më të ulët, ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AAUZH.nr.368/2016 dt.16.02.2017 dhe aktgjykimin e Departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.U.nr.707/2016 dt.08.09.2016 dhe anuloi aktvendimin e të paditurës -AKK nr..... dt..... dhe aktvendimin e Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së P. nr..... dt. ..., duke detyruar këtë Drejtori që në operatin kadastral të bëjë regjistrimin e ndryshimeve mbi paluajtshmëritë nr..... dhe, zona kadastrale P., prej Ndërmarrjes Shoqërore- Ndërtimore ‘.....’ nga P. – në Sh.A. ‘I.’ nga P., në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 63 të LKA-së, ky aktgjykim ka karakter detyrues, kështu që organi kompetent administrativ është i obliguar ta zbatoj pa shtyrje kohe.

Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 54 par 2 dhe 3 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

ARJ.nr.31/2017 dt. 10.05.2018

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Përktheu: F. A.

Kryetari i kolegjit,

Nebojsa Boriçiq